




Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 24.03.2015, mori:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK- 03 - 02-335/15, për z. Jashar Blakaj – Drejtor i Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik në Komunën e Istogut, për shkak se zyrtari i lartë publik ka shmangur gjendjen e konfliktit të interesit në të cilën ndodhej.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për konflikt interesi në ushtrimin e funksionit publik, nr. AKK - 03 - 335/15, për zyrtarin e lartë z. Jashar Blakaj – Drejtor i Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik në Komunën e Istogut, është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin nr. 04/L-051 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

z. Blakaj është hetuar për konflikt të mundshëm interesi për shkak se, krahas ushtrimit të funksionit publik si Drejtor në Komunën e Istogut, ka qenë edhe pronar në biznesin privat N.P.N. "A4".

Fillimisht zyrtari i lartë është njoftuar me shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit për fillimin e procedurës së shqyrtimit të gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit, pas së cilës është takuar me zyrtarët e Agjencisë, për t'i sqaruar situatën në të cilën ndodhet dhe për ndryshimet që duhet të bëj në mënyrë që të shmangë situatën e konfliktit të interesit.

z. Blakaj është bindur për kufizimin si pronar në biznesin privat dhe ka premtuar që do t'i bëj ndryshimet e kërkuara për të shmangur situatën e konfliktit të interesit.

Ndërkohë ka dërguar në Agjenci shkresën zyrtare, të lëshuar nga Agjensioni për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (DPKI 03 – 02/818/15), me të cilën vërtetohet se ka bërë ndryshimet e nevojshme. Me këtë z. Blakaj ka shmangur situatën e konfliktit të interesit në të cilën ndodhej.

II. Në pajtim me nenin 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja, andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik;
- Drejtorit të DPK- së;
- Z./znj. (zyrtarit përgjegjës).

Drejtore i Agjencisë kundër Korrupsionit

Hasan Preteni

